




INSPEKTORATI I PUNËS

02V- 108/25/1427



Inspektorët e Punës në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve - të Inspektoratit Qendror të Punës, Divizioni në Rajonin e Mitrovicës, Inspektori [REDAKTUAR], të autorizuar me dispozitat e Nenit 83, 92 dhe 94 të Ligjit nr.03/L- 212 të Punës, dispozitës të nenit 1, 2 dhe 5 të Ligjit Nr. 2002/9 dhe Ligjit Nr.03/L-017, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Inspektoratin e Punës në Kosovë, procesverbal të inspektimit me nr. 02-108/25/1427 të datës 15.12.2025, procesverbal të riinspektimit me nr. 02-108/25/1427A të datës 12.01.2026, më datën 16.01.2026, merr këtë:

V E N D I M

Për shqiptimin e masës ndëshkimore

Subjekti juridik “Fresco Exclusive” Sh.p.k. me NUI 810834095 (Njesia ne Mitrovicë): rr. “Agim Ramadani- Katana”, Mitrovicë, me pronar [REDAKTUAR] (në tekstin në vijim punëdhënësi) konstatuam këtë gjendje faktike:

- Cenimin e dispozites së nenit 7 paragrafi 4, i Ligjit Nr.03/L-212 i Punës, e sanksionuar me dispozitat e nenit 7 paragrafi 2 nënparagrafi 2.22 të Udhëzimit Administrativ nr.07/2012 Për Përcaktimin e Gjobave dhe Shumave Konkrete për shkelje të dispozitave të Ligjit të punës, i shqiptohet gjoba ne shumë prej: **DYQIND (200) Euro**
- Cenimin e dispozites së nenit 10, i Ligjit Nr.03/L-212 i Punës, e sanksionuar me dispozitat e nenit 7 paragrafi 2 nënparagrafi 2.2 të Udhëzimit Administrativ nr.07/2012 Për Përcaktimin e Gjobave dhe Shumave Konkrete për shkelje të dispozitave të Ligjit të punës, i shqiptohet gjoba ne shumë prej: **DYQIND (200) Euro.**
- Cenimin e dispozites së nenit 55, i Ligjit Nr.03/L-212 i Punës, e sanksionuar me dispozitat e nenit 7 paragrafi 2 nënparagrafi 2.25 të Udhëzimit Administrativ nr.07/2012 Për Përcaktimin e Gjobave dhe Shumave Konkrete për shkelje të dispozitave të Ligjit të punës, i shqiptohet gjoba ne shumë prej: **DYQIND (200) Euro.**

- Gjithsej ndaj subjektit juridik “Fresco Exclusive” Sh.p.k. me NUI 810834095 (Njesia ne Mitrovicë): rr. “Agim Ramadani- Katana”, i shqiptohet Gjoba në lartësi prej Gjashtëqind (600.00) Euro.

Dëftesa mbi pagesën e gjobës merrët në Inspektorat të Punës, adresa: Rr:“Afrim Zhitia” p.n. Mitrovicë, afati i pagesës 30 ditë.

Punëdhënësi duhet të dëshmoj pagesën e gjobës, duke dorëzuar një kopje të pagesës në zyrën e Inspektoratit të Punës, në Mitrovicë, rruga:“Afrim Zhitija”, (Ndërtesa e ish Administratës Pensionale), kati i III-të, zyrja nr.06, në të kundërtën do të konsiderohet se nuk është bërë pagesa dhe do iniciohet procedura përmbaruese tek organet kompetente.

A r s y e t i m

Me rastin e inspektimit në subjektin e lartcekur sipas ankesës anonime me nr. prot 267/25 të datës 04.12.2025, së bashku me kolegun [REDACTED] kemi dalur në inspektim.

Gjatë inspektimit kemi obliguar punëdhënësin që të prezentoj këtë dokumentacion:

- Kontratat e punëtorëve;
- Listën e punëtorëve;
- Listën e pagave;
- Ekzekutimin e pagesave te pages;
- Dëshmi të pagesës së trustit.

Edhe pas afatit të dhënë prej 03 ditëve, punëdhënësi nuk ka prezentuar dokumentacionin e kërkuar me procesverbal.

Nga lëmia e marrëdhënies së punës:

- **Punëdhënësi nuk ka** prezentuar dëshmitë se punonjësit janë të lajmëruar në (ATK), të cilët kemi evidentuar gjatë inspektimit, konform dispozitën së nenit 7 paragrafi 4 i Ligjit nr.03/L-212 i Punës. Në këtë rast është bërë shkelje e dispozitës së nenit 7, i Ligjit nr.03/L-212 i Punës.

- **Punëdhënësi** nuk ka prezantuar kontratat e punës për punëtorët të cilët me raport zyrtar ka qenë i obliguar të prezantoj, konform dispozitës së nenit 10, të Ligjit 03/L-212 i Punës. Në këtë rast është bërë shkelje e dispozitës së nenit 10, i Ligjit nr.03/L-212 i Punës.
- **Punëdhënësi** nuk ka prezentuar dëshmi lidhur me ekzekutimin e pagesës së pagës, konform me dispozitën e nenit 55 i Ligjit nr.03/L-212 i Punës. Në këtë rast është bërë shkelje e dispozitës së nenit 55, i Ligjit nr.03/L-212 i Punës.

Andaj duke u bazuar nga të dhënat e cekura më lartë u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

Punëdhënësi është i obliguar, që në vazhdimësi të bëjë zbatimin e dispozitave të Ligjeve në fuqi, Ligji 03/L-212 të Punës dhe Ligjit 04/L- 161 për Siguri dhe Shëndet në Punë, në të kundërtën moszbatimi i dispozitave të këtyre ligjeve do të merren si masë rëndësuese dhe do të cilësoheni si recidivist.

Një kopje e këtij vendimi i dërgohet subjektit juridik “Fresco Exclusive” Sh.p.k. dhe kopjet tjera mbesin në Inspektoratin e Punës për procedurën e më tutjeshme.

Udhëzim juridik: Kundër këtij Vendimi mund të bëhet ankesë në afat prej 30 ditësh në Komisionin e Ankesave të MFPT-së, nëpërmes Inspektoratit të Punës në Mitrovicë, Rruga: “Afrim Zhitia”, ish objekti i ndërtesës pensionale, kati i dytë, nr.34, Mitrovicë.

Data: 16.01.2026

Ora: 10:00.

Inspektorët e Punës

~~_____

_____~~